

**“Mjedisi Sot”**  
**Nr 2197 E Merkure 19/09/2007**

Pergatitur nga Qendra Rajonale e Mjedisit

Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Kati III

Kutia postare 127, Tirane

Tel/Faks (+355 4) 23 29 28

Email: [info@albania.rec.org](mailto:info@albania.rec.org)

Web: <http://albania.rec.org>

[www.mjedisisot.info](http://www.mjedisisot.info)

## PERMBAJTJA

\*\*\*\*\*

### NGA VENDi

- Lushnja, qyteti me ujin me te ndotur ne vend
- Bllokohet pika inerte, po shfrytezonte ilegalisht shtratin e lumit Erzen
- Klima, rritja e temperaturave rrit vdekshmerine me 3 per qind

\*\*\*\*\*

### NGA BOTA

- Thirrje per te mbrojtur peshkaqenet e detit
- Uzinat energjitike me lende fosile fitojne kredite karboni

\*\*\*\*\*

### Njoftime

- Aktivitete me rastin e javes pa makina
- REC Shqiperi: Vend pune prane projektit te Liqenit te Shkodres
- Seminar per prezantimin e Planit Strategjik te Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit
- Earthcorps International Program - International outreach trainer position announcement
- 11th international specialized conference on watershed & river basin management

**Te gjitha OJF-te mjedisore dhe ato qe kryejne aktivitetet per mjedisin, jane te mirepritura te dergojne informacione ose njoftime, ne adresen 'Mjedisi Sot' [info@albania.REC.org](mailto:info@albania.REC.org), ose Kutia Postare 127, Tirane.**

**Pergatitja e lajmeve ditore eshte mundesuar ne saje te mbeshtetjes nga Agjencia Spanjolle per Bashkepunim Nderkombetar – AECI.**

\*\*\*\*\*

Nga VENDI

Lushnja, qyteti me ujin me te ndotur ne vend  
Gazeta Shqip online

Instituti i Shendetit Publik, pas kontrolleve dhe monitorimit te cilesise se ujit ne te gjitha qytetet e vendit, ka konstatuar edhe zonat me problematike. Ne kete vezhgim te kryer nga ana e specialisteve te ISHP-se, bie ne sy se qyteti me ujin me te ndotur me ngarkesa mikrobiologjike eshte Lushnja. Ne kete qytet, specialistet pohojne se situata nuk ka ndryshuar as nga muajt paraardhes, kur jane kryer monitorimet e tjera. "Shqetesuese edhe per muajin gusht mbetet situata ne qytetin e Lushnjes, ku pikat e monitorimit pasqyrojne te njejten situatë dhe nivel ndotjeje te ujit si ne muajin korrik", shprehet Valbona Bara, specialiste ne Seksionin e Ujit te Pijshem, prane ketij institucioni. Pikerisht, per nje situatë te tille, sipas specialistes Bara, per te gjitha pikat e konstatuara me probleme i jane lene detyrat perkatese Ndermarrjes se Ujesjelles Kanalizimeve ne kete qytet. Uje plotesisht te paster nuk konsumon as kryeqyteti, qe jo pak here eshte vene ne qender te vemendjes nga ndonje epidemi verdheze. Megjithate, specialistet e ISHP-se pohojne se ndotja e ujit e vene re kete periudhe eshte sporadike. Ne kete linje, specialistja Bara jep edhe shpjegimet perkatese. Ajo pohon se "ndotja sporadike e ujit te pijshem ne qytetet e vendit konstatohet nga ngarkesat mikrobiologjike qe paraqiten ne dite dhe ne pika te vecanta te monitorimit, si pasoje e amortizimit te brendshem te rrjetit". Nderkohe qe sqaron me tej duke shtuar se, "krahasuar me muajt e tjere te stines se veres, rezultatet tregojne per nje renie te nivelit te ndotjes ne ujin e pijshem". Specialistet e ISHP-se, pas vleresimit te materialit monitorues, kane arritur ne rezultatin se "rastet sporadike te ngarkesave mikrobiologjike ne ujin e pijshem jane konstatuar ne disa pika monitorimi ne Tirane, Durres, Vlore dhe Kucove". Ne qytetin e Tiranës eshte konstatuar ndotje ne tri pika monitorimi, te cilat i perkasin "Bulevardi Zogu I", rruga "Budi" dhe ajo "4 Shkurti". Ndersa, ne qytetin e Vlores jane evidentuar dy pika me uje te ndotur, perkatesisht ne lagjen "Clirimi" dhe ate te quajtur "Pusi i Mezinit". Monitorimi i permuajshem i ujit te pijshem ne te gjithë vendin behet me qellim marrjen e masave per parandalimin e semundjeve te shkaktuara nga papastertite hidrike. ISHP eshte nje strukture ne varesi te Ministrise se Shendetesise. Ajo ka perfunduar te dhenat e plota te monitorimit per muajin gusht, sipas te cilave, ndotja e ujit te pijshem konsiderohet sporadike. Monitorimi i ujit te pijshem kryhet cdo dite ne te gjithë vendin, permes nje sistemi kombetar monitorimi. Drejtorite e Shendetit publik ne rrethe kane strukturat e vecanta te inspektimit sanitar per ujin e pijshem dhe laboratore perkates, ku kryhet analizimi i indekseve mikrobiologjike, fiziko-kimike (shija, era, ngjyra, turbulencat, amoniaku, nitritet, nitratet ne uje) dhe niveli i klorifikimit te ujit te pijshem, sipas rekomandimeve te percaktuara nga Ministria e Shendetesise. Numri i pikave te monitorimit te ujit percaktohet ne varesi te popullates se nje qyteti, qe furnizohet me uje te pijshem nga Ndermarrja e Ujesjellesit. Rreziku qe vjen nga uji i ndotur me papasterti dhe ngarkese te larte mikrobaktereologjike reflektohet ne shkaktimin e epidemive. Sipas specialisteve, ai mund te shkaktojë deme serioze per shendetin e njeriut deri ne shkaterrimin e melcise per shkak te virusit te hepatitit. Veren e kaluar ne kryeqytet per shkak te ujit te pijshem te ndotur u shfaq nje epidemi verdheze, ndonese e parnuar nen ze nga ana e autoriteteve. Mjeket keshillojne qe ne rastet kur uji nuk eshte i paster, ai duhet te konsumohet vetem pasi eshte ziere.

Gjithashtu, nuk duhet te perdoret per femijet.

\*\*\*\*\*

Bllokohet pika inerte, po shfrytezonte ilegalisht shtratin e lumit Erzen  
Gazeta Metropol, online

Nje kontroll i befasishem i ushtruar ne shtratin e lumit Erzen ka pasuar me bllokimin e tre mjeteve germuese dhe te disa mjeteve te tjera te renda transportuese te zhavorrit te lumit. Aksioni eshte drejtuar nga prefekti Klodian Pajuni dhe ne te kane qene te pranishem shefi i komisariatit te policise se komisariatit te Durrës, Aleks Hajdari dhe shefi i Policise Tatimore, Bedri Luku. Shfrytezimi i paligjshem i shtratit te Erzenit, si dhe ankesat e shumta kane nxitur prefektin Pajuni te organizoje nje grup pune dhe te shkoje ne terren per te bllokuar mjetet germuese. Aksioni eshte perqendruar ne fshatin Cizmeli te komunes se Gjepalaj ne te cilin eshte gjetur ne pune e siper nje ekskavator dhe nje kamion i tonazhit te rende. Ndersa policia i ka vendosur ne gjendje te bllokuar te dy mjetet, vetem pak meter me tej dy ekskavatore te tjere ishin strehuar e fshehur ne rreze te malit me inerte. Krahas kamionit me targa DR 1054 E efektivat e policise rrugore kane ndaluar dhe me pas bllokuar edhe dy te tille ne levizje e siper, pronaret e te cileve i kane deklaruar policise se zhavorri do te transportohej per ne nje nyjen larese me te cilin shfrytezuesi i lumit kishte kontrate gojore. Pas ketij informacioni, Policia Tatimore dhe ajo e qarkullimit rrugor kane shkuar ne kantierin e firmes se vellezerve Kokomani per te pare inventarin e mjeteve si dhe anen dokumentare te ketij subjekti privat. Shefi i Policise Tatimore, Bedri Luku, eshte shprehur se transporti i mallrave pa fature dhe shmangia e detyrimeve tatimore ne raste te tilla perben penalitet, ndersa prefekti ka pohuar se lumi Erzen eshte shfrytezuar ne menyre te kunderligjshme dhe kjo pritet ta ballafaqoje pronarin e deklaruar te shfrytezimit te inerteve me vendosjen para drejtesise. Nga pohimet e personit qe ka shfrytezuar qindra m2 hapësire ne shtratin e lumit thuhet se toka i eshte dhene nga vete pronaret e tokes qe jane banore te fshatit kundrejt pageses dhe se shfrytezimin e zhavorrit e bente per te mbajtur ekonomine familjare.

\*\*\*\*\*

Klima, rritja e temperaturave rrit vdekshmerine me 3 per qind  
Gazeta Albania online

“Per cdo grade rritjeje temperature, mbi nje prag limit, vihet re nje rritje e vdekshmerise prej 3% ne qytete te vecanta”. Pra, vdekshmeria eshte e lidhur me luhatjet e nxehtesise e me ndryshimet klimatike. Eshte drejtori i programit special ambiental te Europes, Roberto Bertolini, ai qe ka leshuar alarmin, ne fjalen e tij ne konferencen mbi ndryshimet klimatike ne Rome. Ky alarm nenvizon lidhjen e ngushte qe kane efektet e ndryshimeve klimatike me shendetin dhe jetegjatesine e njerezve. Sipas Bertolinit, problemi prek, mbi te gjitha, “hapesirat metropolitane”, pra qytetet e medha. Kjo ceshtje eshte e lidhur me “luhatjet e temperatures, qe jane nje nga problemet e ndryshimeve klimatike”. Pikerisht per shkak te ketyre ndryshimeve, “te gjitha luhatjet e temperaturave qe ngrihen godasin fillimisht me te rrezikuarit: te moshuarit dhe femijet”. Qytetet e medha jane zonat qe preken me shume nga fenomeni dhe ku luhatjet e nxehtesise rrisin me 3% shkallen e vdekshmerise. Ne keto zona metropolitane, ne fakt, ka nje sere faktoresh me ndikim te ngadalte si ndotjet atmosferike, qe mund te rrisin demet”. Nje shembull se si ndryshimet ndikojne mbi variablat shendetesore eshte ardhja nga Shqiperia, “ne vitet ‘90 i mushkonjes tiger” qe pastaj “eshte strehuar dhe eshte shperndare shpejt fale klimes qe ka gjetur”. Perhapja, shton Bertolini, e agjenteve transmetues, si insektet dhe mushkonjat, eshte “ndihmuar dhe favorizuar nga ndryshimet klimatike”. Nder te tjera, sipas drejtorit te OMS, “nevojitet nje vezhgim shendetesor per kujdesin dhe pasojat”. Dhe me pas perfundon se eshte i domosdoshem “nje instrument qe i jep frymemarrje te re, nje rregullim i ri, nje plani shendetesor

mbikqyrjeje epidemiologjike, per te bere te dukshme lidhjet mes patologjive, vdekshmerise dhe ndryshimeve klimatike”.

\*\*\*\*\*

NGA BOTA

## THIRRJE PER TE MBROJTUR PESHKAQENET E DETIT

Deti i Koraleve eshte nje nga te paktat vende ku strehone peshkaqenet kokecekani.

Ambjentalistet i kerkojne qeverise australiane te mbrojne Detin i Koraleve, nje nga vendet e fundit tropikale pa jete te gjalle detare.

Deti eshte kohet e fundit si nje “nje pike e nxehte e llojeve grabitqare” per shkak te popullatave te pasura me peshkaqen.

Ambjentalistet kane frike se rajoni mund te kthehet ne shenjester e peshkimit ilegal te peshkaqeneve, ashtu sic ndodhi me kerkuesit e gazit dhe te naftes.

Grupet mjedisore e kane pershkruar Detin e Koraleve si nje rruge trullosese e ujit blu e mbushur me grabitqare oqeanike.

Per me shume informacion:

<http://news.bbc.co.uk/2/hi/asia-pacific/6998121.stm>

\*\*\*\*\*

Uzinat energjitike me lende fosile fitojne kredite karboni  
ENDS Europe DAILY 2388

Investitoret e projekteve qe synojne permiresimin e eficences se uzinave energjitike me qymyrguri dhe lende te tjera djegese, ne vendet ne zhvillim, mund te aplikojne per te marre kredite karboni, sipas mekanizmit per zhvillim te paster (CMD) te Protokollit te Kiotos.

Bordi ekzekutiv i CMD-se ka pranuar metodologjine per perllogaritjen e shumes se krediteve, duke hapur rrugen per investitoret qe te certifikohen “per reduktimin e shkarkimeve” permes protokollit. Ky mekanizem i lejon vendet e zhvilluara te investojne ne projekte per reduktimin e shkarkimeve dhe t'i kompensojne shkarkimet ndotese qe ata prodhojne. Kioto gjithmone e sheh te pranueshme perdorimin e projekteve per energji te pastra, ne kuader te mekanizmit per zhvillimin e paster, por vetem per nje metodologji eshte rene dakort deri me tani.

Metodologjia e aprovuar eshte bazuar ne propozimet per uzina te reja me qymyr ne Kine dhe ne Indi. Ketu perfshihen elemente per kufizimin e numrit te krediteve qe mund te fitohen. Ne kete menyre ky mekanizem do te ndaloje perdorimin e lendeve fosile ose konkurrencen ndaj energjise se rinovueshme, thekson bordi.

WWF per Evropen e mirepret kete levizje si nje hap perpara ne ngritjen e uzinave per kapjen dhe depozitim e karbonit ne vendet e zhvilluara.

Per me shume informacion:

<http://unfccc.int:80/2860.php>

\*\*\*\*\*

Njoftime

AKTIVITETE ME RASTIN E JAVES PA MAKINA

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, ne bashkepunim me Shoqaten G&G Group, ne kuadrin e “Javes pa Makina”, organizon:

Diten e Premte, dt. 21/09/2007, ora 19.00 – 22.00, ne mjediset e jashtme te kompleksit Taiwan, shfaqjen e Dokumentareve Mjedisore

Diten e Shtune, dt. 22/09/2007, ora 10.00 ne rrugen e Duresit, para Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, Ceremonine e levizjes se lire (shetitje, ciklizem e atletike) dhe paralel me te ne Sheshin “Nene Tereza” (ekspozite mjedisore, piktura mbi mjedisin) me nxenesit e shkollave dhe grupet e interesit.

Ftohen te gjitha te interesuarit dhe dashamiresit e mjedisit te marrin pjese ne keto aktivitete.

\*\*\*\*\*

REC Shqiperi: Vend pune prane projektit te Liqenit te Shkodres

Pozicioni: Asistent/e Projekti

Kuadri i punes:

- ndihmese ne organizimin e takimeve dhe aktiviteteve te tjera ne kuader te projektit
- ndihmese ne punen e zyles per fotokopje, skedime, shkrim dhe pergatitje materialesh

Pervoja dhe aftesite e kerkuara:

- Shkollim i larte. Shkollimi dhe njohurite per mjedisin do te shihen si perparesi e kandidatit
- Pervoje e meparshme pune ne projekte
- Aftesi te mira te punes ne kompjuter (Word, Excel)
- Njohje e mire e gjuhes angleze (me shkrim dhe te folur)
- Aftesi per te punuar ne grup dhe ne disa projekte njekohesisht.

Aplikimet duhet te permbajne:

- Leter interesi per punesim;
- Nje biografi personale; dhe
- Fotokopje te dokumentacionit qe tregon permbushjen e kerkesave te mesiperme.

Personi i perzgjedhur do te punoje prane Qendres Rajonale (REC), Zyra e Projektit ne Shkoder.

**Dorezimi i aplikimeve: deri me 20 shtator 2007, prane:**

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)

Zyra e Projektit ne Shkoder

Lgj. Qemal Stafa, Rr. Vasil Shanto P. 23, Shkoder

Tel/faks: (022) 47 203

ose

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)

Zyra ne Shqiperi

Rr. Ismail Qemali, Nr.21, Tirane

Kutia Postare 127

Tel/faks: (04) 232 928

\*\*\*\*\*

seminar per prezantimin e Planit Strategjik te Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave te Shqiperise dhe UNDP Shqiperi do te organizojne seminarin permbylles "Shqiperia – Plani Strategjik i Veprimit te Kapaciteteve per Menaxhimin e Integruar te Mjedisit" (NCSA) ne 27 Shtator, 2007, ne Hotel "Tirana International". Seminari fillon ne oren 10:00.

Plani Strategjik i Veprimit eshte mbeshtetur ne fushat e perbashketa te tre Konventave te Rios, permes vleresimit dhe analizes se nevojave prioritare te vendit per zbatimin e Konventave Globale Mjedisore dhe pasqyron ne terma praktike aktivitetet qe duhet te ndermerren per krijimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe te strukturave mbeshtetese me qellim menaxhimin e koordinuar e strategjik te mjedisit ne Shqiperi. Plani Strategjik i Veprimit te Kapaciteteve do te krijojte nje mjedis lehtesues per ruajtjen e biodiversiteti unik te vendit, do te lehtesoje zbutjen e vulnerabilitetit nen kushtet e ndryshimeve klimatike si dhe do te ndihmoje ne koordinimin e masave qe duhen marre per te luftuar shkretetirizimin dhe degradimin e tokes, duke ndihmuar ne te njejten kohe zbatimin e parimeve te zhvillimit te qendrueshem.

Pjesemarresit e seminarit jane perfaqesues te Ministrive te linjes, institucioneve kerkimore dhe arsimore, eksperte kombetare, OJF, si dhe perfaqesues te institucioneve financuese.

Per me shume informacion kontaktoni:

Klodi Marika

NCSA/SLM

Manager

[klodi.marika@undp.org](mailto:klodi.marika@undp.org)

\*\*\*\*\*

EarthCorps International Program - International Outreach Trainee Position Announcement

Position description

The International Outreach Trainee position is a training level, seasonal position in EarthCorps. EarthCorps provides environmental restoration training to emerging leaders, along with leadership training, community service and multicultural understanding of local and global issues. The Outreach Trainee's two primary responsibilities are to facilitate field projects for community and agency partners within the EarthCorps Outreach division and to gather and develop materials to start or support an environmental outreach program in his/her home country. This position reports to the Outreach Program Manager.

Duties and responsibilities

Professional Networking and Workshops:

- Participates in structured series of field, workshop, and classroom trainings. Training will focus on ecological restoration and stewardship, environmental education and youth leadership development.

Youth and Community Outreach Projects:

- Community events at various sites in the Seattle area & special Earth Month events in April.

#### International Project:

- Writes Individual project proposal in conjunction with sponsored NGO.
- Researches and carries out fundraising opportunities to support project.

#### Program Support & Administrative:

- Assists other EarthCorps programs/staff as assigned.
- Attends all required staff meetings.
- Completes necessary paperwork in a timely manner. (Training logs, timesheets, etc).
- Prepares oral and written reports of training projects, equipment use and maintenance, project reports and incident reports.

#### Project Implementation:

- Develops and implements outreach programming and field projects in conjunction with field staff, as well as with community and government agencies.
- Facilitates restoration-based service-learning programs.
- Trains volunteers in environmental restoration techniques.

#### Training Supervision:

- Maintains appropriate standards of behavior, policies and procedures of EarthCorps.
- Provides leadership and direction in support of program goals and mission.
- Assists in counseling, motivation and discipline of individual program participants.

#### Communication:

Supports efforts of EarthCorps.

Promotes the health and well being of EarthCorps, staff and corpsmembers in all communications.

Resolves issues/concerns directly with EC staff/corps members or that person's supervisor.

#### Outreach trainee's terms of service

Status: Volunteer, temporary

Period of training: mid January, - mid December, 2008

Stipend: \$360 / month

Hours of training: 7:30 am – 5:00 pm Mon-Fri; approx. every other Friday off

3-4 multi-day program retreats outside of Seattle throughout program

Possible camping for 2-3 weeks of program

#### Benefits:

Travel Insurance premium paid for volunteer only.

Bus passes provided during term of service

Airfare to and from Seattle may be partially paid by EarthCorps

Homestay family in Seattle (provides a private bedroom and meals)

Boots, pant, T-shirt and rain gear provided

#### Required qualifications

5 years practical experience in the environmental field

-Or-

4 years post secondary education, plus one year of work experience in a field related to the environment.

- Interest in environmental fieldwork, intercultural knowledge and educational activities
- Commitment to teamwork with peers from around the world
- Desire to engage in service learning
- Support from a sponsoring organization
- Conversational English
- No Criminal Record

To apply

Candidates should be referred to EarthCorps by an environmental organization (i.e. NGO, LGU, community group or student club).

Materials are available online at: [http://www.earthcorps.org/join\\_international.php](http://www.earthcorps.org/join_international.php).

Application materials will be sent for the candidate upon confirmation of the referring organization. Referring organizations should have completed the Partner Application Form and send the Candidate Nomination to: [mark@earthcorps.org](mailto:mark@earthcorps.org)

Deadlines and start dates:

- **Application Deadline: September 21, 2007**
- Participant selection: October 2007
- Visa processing: October 2007 - December 2007
- Travel confirmation: January 4, 2008
- EarthCorps Program starting date: mid-January 2008
- EarthCorps Program graduation: mid-December 2008

\*\*\*\*\*

## 11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management

The International Water Association is going to organize 11th International Specialized Conference on Watershed & River Basin Management on 4-5 September 2008 in Budapest.

The Call for Papers in electronic form (CfPe) which gives a summary of the most important information about the conference can be found on: [www.iwa2008budapest.org](http://www.iwa2008budapest.org)

*Water is a challenge for the century.*

Exploring the sustainability of our most valuable resource is our business. IWA presents a unique opportunity to engage in 2 days of innovative discussion on the subjects of Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls and Monitoring and Modelling.

Join other experts in exchanging ideas and exploring networking opportunities during the IWA Watershed and River Basin Management Conference, 4-5 September 2008 in beautiful Budapest, Hungary. Mark this event on your calendar and begin to plan abstract / paper / poster today.

*Topics of the Conference:*

Include but are not limited to Water Resource Management, Climate Change, Water Supply Protection, Sustainable Urban Drainage, Pollution Sources & Controls, Monitoring and Modelling.

- River basin management planning under the EU Water Framework Directive;
- River basin management practices in different continents;

- Managing water resources in transboundary river basins with conflicting demand;
- Managing competing uses to protect water quality and quantity;
- Watershed management methods to facilitate water availability for aquatic ecosystem health and human uses;
- Interconnecting sub-watersheds to achieve basin goals;
- Hierarchical approaches to river basin management.
- Monitoring, ecological classification in EU countries and intercalibration;
- State-of-the-art in assessing water and biological quality and integrating data.;
- Programme of measures and ecological state.
- River basin management, advanced computation and decision support;
- The impact of climate change on watersheds, river basins, estuaries and reservoirs;
- Flood control and prevention.
- Effective methods to involve stakeholders and the public into the river basin management planning processes;
- Conflicts and multi-objective management – is it mostly methodology?
- Economics of River Basin Management.

The internet site of the conference is already open ([www.iwa2008budapest.org](http://www.iwa2008budapest.org)) and interested candidates could submit abstracts under the Registration menu.

**The abstract submission period is open until the end of September 2007.**

\*\*\*\*\*

C'eshte "Mjedisi Sot"

"Mjedisi Sot" eshte nje nga botimet periodike te Qendres Rajonale te Mjedisit - Zyra ne Shqiperi. Ne kete botim ditore do te gjeni lajme dhe probleme mjedisore nga shtypi i dites, informacion per aktivitetet mjedisore nga vendi dhe bota.

Per t'u futur falas ne listen e shperndarjes se "Mjedisi Sot" ose per t'u cregjistruar, dergoni nje e-mail ne adresen: [info@albania.REC.org](mailto:info@albania.REC.org)

Versionin e shtypur mujor te "Mjedisi Sot" mund ta gjeni prane Zyres se REC ne Shqiperi.

Lajmet mjedisore ditore dhe "Mjedisi Sot" mujor mund t'i gjeni edhe ne internet: <http://albania.REC.org>  
[www.mjedisisot.info](http://www.mjedisisot.info)

\*\*\*\*\*

C'eshte REC

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) per Evropen Qendrore e Lindore eshte nje organizate nderkombetare jopartizane, joavokate, jofitimprurese qe mbeshtet zgjidhjen e problemeve mjedisore ne Evropen Qendrore e Lindore (EQL), duke nxitur bashkepunimin ndermjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktoreve te tjere mjedisore, si dhe duke mbeshtetur shkembimin e lire te informacionit dhe pjesemarrjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore.

REC eshte krijuar ne 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot REC, bazohet ligjerisht ne Karten e tij, nenshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian, dhe ne nje marreveshje nderkombetare me qeverine hungareze. REC ka zyren qendrore ne Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve ne secilin prej 16 vendeve perfituese. Shqiperia e ka nenshkruar Karten e REC ne 1992. Zyra e REC per Shqiperine eshte hapur ne 1994. Kjo zyre punon per realizimin e misionit te REC

duke mbeshtetur organizatat jofitimpruese, institucionet mjedisore ne te gjitha nivelet, dhe aktore te tjere te interesuar ne fushen e mjedisit, duke mbeshtetur proceset pjesemarrrese dhe shkembimin e lire te informacionit. Fushat kryesore te veprimtarise jane: Programi i granteve per OJF-te; Planet Lokale te Veprimit ne Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit per OJF-te dhe zyrtare te mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj.

\*\*\*\*\*

\*\*\*\*\*

Nese jeni te interesuar te njiheni me cfare ndodh cdo dite ne mjedisin shqiptar dhe neper bote, abonohuni falas ne "Mjedisi Sot", pakete e perditshme elektronike. Dergoni nje mesazh me titull "Abonim" tek [info@albania.rec.org](mailto:info@albania.rec.org)

\*\*\*\*\*